



ETHICS AND COMPLIANCE DEPARTMENT

# POLITIKA KUNDËR KORRUPSIONIT

11/2020

<b>QËLLIMI I KËSAJ POLITIKE</b>	<b>4</b>
<b>OBJEKTI I ZBATIMIT</b>	<b>4</b>
<b>PËRKUFIZIMET</b>	<b>5</b>
<b>KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR</b>	<b>8</b>
<b>PAGESAT PËR NDËRMJETËSIMIN</b>	<b>10</b>
<b>MARRËDHËNIET ME ZYRTARËT PUBLIKË*</b>	<b>12</b>
<b>TENDERAT PUBLIKË DHE PRIVATË</b>	<b>13</b>
<b>DHURATAT DHE FTESAT</b>	<b>15</b>
<b>KONFLIKTI I INTERESAVE</b>	<b>17</b>
<b>VLERËSIMI I RREZIKUT TË KORRUPSIONIT NË MARRËDHËNIET ME PALËT E TRETA NË PËRGJITHËSI</b>	<b>19</b>
<b>MARRËDHËNIE ME AGJENTËT DHE NDËRMJETËSIT</b>	<b>22</b>
<b>PËRFAQËSIMI I INTERESAVE DHE LOBIMI</b>	<b>25</b>
<b>PATRONAZHI, DONACIONET DHE SPONSORIZIMET</b>	<b>28</b>
<b>BURIMET NJERËZORE - KONTRAKTIMI - PUNËT SI KONTRAKTORË TË PAVARUR OSE PRAKTIKAT PROFESIONALE</b>	<b>30</b>
<b>MESAZH NGA KRYETARI DHE SHEFI EKZEKUTIV</b>	<b>32</b>
<b>ZBATIMI I POLITIKËS KUNDËR KORRUPSIONIT</b>	<b>35</b>
<b>SHTOJCË - PËRKUFIZIME</b>	<b>37</b>
<b>MESAZH NGA KRYETARI DHE SHEFI EKZEKUTIV</b>	

## Mesazh nga kryetari dhe shefi ekzekutiv

3



„Korrupsioni godet si vendet e zhvilluara, ashtu edhe ato në zhvillim, si agjencitë publike, ashtu edhe subjektet private. Ai cenon besimin e qytetarëve të institucionet publike, dobëson popullatat e dobëta dhe krijon një terren që ushqen dhunën. Ne duhet ta adresojmë këtë plagë globale me vendosmërinë më të madhe.

E pranishme në pothuajse 70 vende, kompania Saint-Gobain është e përkushtuar për ta ushtruar biznesin e saj në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme. Lufta kundër korrupsionit dhe ushtrimit të influencës është në thelb si të angazhimeve tona ndërkombëtare, ashtu edhe të Parimeve të Etikës dhe Veprimtarisë. Kjo Politikë kundër Korrupsionit i plotëson dhe i ilustron këto parime për të sqaruar më tej se cilat janë sfidat dhe se si mund të përballet me to secili prej nesh.

Unë kam ndërmarrë një angazhim personal, në emër të Grupit, për të kontribuar në luftën kundër korrupsionit dhe ushtrimit të influencës. Megjithatë, ne do ta fitojmë këtë betejë nëse e ndërmarrin këtë luftë të gjithë së bashku: secili prej nesh duhet të angazhohet personalisht për të vepruar në përputhje me këtë Politikë kundër Korrupsionit. Saint-Gobain i përmbahet parimit të tolerancës zero në këtë aspekt.

Unë kam besim tek secili prej jush dhe ju falënderoj për angazhimin e palëkundur ndaj kësaj çështjeje!”

**Pierre-André de Chalendar,**  
předseda představenstva a výkonný ředitel Saint-Gobain

## Qëllimi i kësaj politike

Korrupsioni cenon ekonominë, rrit pabarazitë dhe pengon zhvillimin e qëndrueshëm në të gjithë botën. Ndonëse i paligjshëm në pothuajse çdo vend, korrupsioni mbetet një plagë që secili nga ne duhet të vazhdojë ta luftojë në mënyrë aktive.

Prandaj edhe që në fillim të vitit 2003, Saint-Gobain ka shprehur angazhimin e tij të fortë për ta luftuar korrupsionin, veçanërisht përmes:

- Zbatimit të Marrëveshjes Globale të Kombeve të Bashkuara, specifikisht parimit të saj të 10-të që i inkurajon kompanitë që ta luftojnë korrupsionin në të gjitha format e tij; dhe
- Duke përfshirë respektimin e ligjit dhe veçanërisht luftën kundër korrupsionit në thelb të Parimeve të Etikës dhe Veprimtarisë së kompanisë.

Për ta përmbushur këtë angazhim, Grupi ka hartuar edhe një program kundër korrupsionit, ku përcaktohen detyrimet për parandalimin dhe identifikimin e korrupsionit, të cilat reflektohen në një politikë me tolerancë zero ndaj korrupsionit dhe ushtrimit të influencës.

Qëllimi i kësaj Politike është që të shpjegojë dhe të ilustrtojë llojet e ndryshme të sjelljes që janë të ndaluara për shkak se mund të çojnë në korrupsion ose në ushtrim të<sup>1</sup> paligjshëm influence.



Politika kundër Korrupsionit zbatohet për të gjithë punonjësit e kompanisë dhe degët e Grupit, pavarësisht se ku e ushtrojnë ato aktivitetin.

Grupi Saint-Gobain („**Saint-Gobain**“ ose „**Grupi**“) i referohet kompanisë Compagnie de Saint-Gobain dhe të gjitha kompanive të saj të kontrolluara si<sup>4</sup> e vetme ose bashkërisht t. Në lidhje me joint-ventures, ku Saint-Gobain nuk zotëron një interes kontrollues, përfaqësuesit e Grupit duhet që, në mungesë të një politike ekuivalente, të kërkojnë nga organi drejtues i shoqërisë aksionere miratimin dhe zbatimin e kësaj Politike.

Politika kundër Korrupsionit përbën bazën e politikave, procedurave dhe tabelave të tjera praktike, të cilave u referohet kjo politikë dhe që duhen respektuar bashkë me të. Këto dokumente shërbejnë për plotësim dhe qartësim të kësaj Politike nga pikëpamja operative.

<sup>2</sup> „Kontrolli“ nënkupton zotërimin apo mbajtjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të më shumë se 50% të të drejtave të votës në një kompani dhe/ose të pushtetit, me ligj ose faktik, për drejtimin e kompanisë ose për caktimin e menaxhimit të saj të lartë.



*Termat e shënuar me një yll janë të përkufizuar në Shtojcën e kësaj politike.*

## Çfarë është korrupsioni?

Korrupsioni është akti i të kërkuarit, të ofruarit, të të dhënit ose të të rënit dakord në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për të dhënë një avantazh të padrejtë (ose avantazh potencial) një personi për përfitimet e tij (ose për përfitimet e një personi tjetër) me qëllim që ai të bëjë ose të mos bëjë diçka në kryerjen e detyrave të tij (ose për shkak se ka bërë ose nuk ka bërë diçka të tillë).

Kështu, aktet e korrupsionit mund të kryhen:

- Qoftë në mënyrë **aktive** (ofrim/dhënie ryshfeti ose një avantazhi të padrejtë) qoftë në mënyrë **pasive** (pranim ryshfeti/kërkim i një avantazhi të padrejtë);
- Qoftë në lidhje me **publikun** (një ose më shumë zyrtarë publikë\*), qoftë me **subjekte private**;
- Qoftë në mënyrë të **drejtpërdrejtë** ose të **tërthortë** (përmes agjentëve, ndërmjetësve, nënkontraktorëve, ose palëve të treta); dhe
- Pavarësisht nëse ryshfeti\* është **paguar faktikisht** ose **thjesht është ofruar** (nga këndvështrimi i ligjit, ofrimi, premtimi apo kërkimi i një ryshfeti\* është po aq i dënueshëm sa edhe të paguarit faktik të ryshfetit\*);
- Pavarësisht **nëse** është rënë faktikisht dakord për ryshfetin\* (avantazhet mund edhe të jepen pas kryerjes së veprimit të kërkuar).

Termi „**avantazh**“ i referohet jo vetëm **shumës** së **parave** (që zakonisht quhet „ryshfet\*“), por edhe:

- Dhuratave, dreka/darkave, ftesave, argëtimeve, etj.;
- Trajtimi preferencial, si ofertat e punës apo dhënia e mundësive të praktikës së punës në interes të rrethit të ngushtë të familjarëve dhe miqve të personit që ofron ryshfetin; dhe

- Avantazhe në natyrë, si dhënia e informacioneve konfidenciale, ofrimi i akomodimit luksoz për përdorim privat, të paguarit e një udhëtimi, etj..

Kompensimet e kërkuara ose të pritura për avantazhe të tilla mund të përbëhen zakonisht nga:

- Lidhja apo rinovimi i një kontrate;
- Marrja e një uljeje çmimi për mallra apo shërbime;
- Shkëmbimi i informacioneve konfidenciale me një kompani konkurrenente;
- Marrja ose rinovimi i një kontrate për prokurime publike;
- Marrja e një vize, një leje ndërtimi, një licence biznesi; ose
- Marrja e një avantazhi tatimor apo doganor, etj.

Të gjitha palët e përfshira në kryerjen e një akti korrupsioni janë objekt i sanksioneve: dhënësi i ryshfetit (dhe çdo ndërmjetësues që vepron si bashkëpunëtor i tij) dhe marrësi i ryshfetit.

### **Një kontratë në këmbim të një banjoje falas.**

Në kuadrin e thirrjeve publike për tendera për rinovimin e kushteve sanitare të të gjitha shkollave në qytet, kryetari i bashkisë kontakton menaxherin e një pike shpërndarjeje. Kryetari i bashkisë ofron që t'i japë kontratën asaj pike specifike me kusht që kjo pikë t'i ofrojë materiale ndërtimi në shtëpi, pasi ai ka në plan të rinovojë banjën në shtëpinë e tij.

**NDALOHET.** Kjo ofertë ka për qëllim që t'i japë një avantazh të padrejtë një zyrtari publik të zgjedhur në këmbim të nënshkrimit të një kontrate për një tender. Ky është veprim korruptiv.



## Çfarë është influencimi i padrejtë?

Influencimi i padrejtë është akti i ofrimit, dhënies apo dakordësimit për të dhënë, (ose të kërkuarit ose të pranuarit), në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një përfitimi apo të një pagese nga një person që ka influencë reale ose potenciale në vendimmarrjen e një zyrtari publik. Ky akt kryhet me qëllim që personi në fjalë ta bindë vendimmarrësin që të veprojë në mënyrën e dëshiruar.

Këtu duhet të përfshihen të paktën tre persona:



**përfituesi:** personi që kërkon të marrë një vendim të favorshëm dhe që ofron për të një përfitim ose pagesë;



**ndërmjetësi:** personi që është në gjendje të influencojë tek vendimmarrësi dhe që merr përfitimin ose pagesën; dhe



**targeti:** personi që ka kompetencat e vendimmarrjes (zyrtar publik\*, autoritet publik, agjenci administrative etj.).

Këtu dallojmë:

- influencimin e padrejtë aktiv, që është ushtrimi i ndikimit për përfituesin e një vendimi të pritshëm
- ushtrim i ndikimit pasiv, që është ushtrimi faktik nga ndërmjetësi i aftësisë së tij për të influencuar vendimmarrësin dhe që kërkon ose merr një përfitim.

Ashtu sikurse me korrupsionin, procedimet ligjore mund të iniciohen pavarësisht nga:

- nëse ndërmjetësi e pranon apo jo përfitimin ose pagesën (thjesht oferta, premtimi apo të kërkuarit e një përfitimi apo pagese është e mjaftueshme për fillimin e procedurës);
- është dhënë realisht përfitimi ose pagesa e premtuar ose e ofruar;
- ndërmjetësi e përdorë vërtet influencën e tij;
- vendimi i favorshëm është marrë realisht; dhe
- avantazhi i ofruar apo i dhënë është një pagesë, dhuratë, përfitim në natyrë, etj.

Në shumicën e vendeve, influencimi i padrejtë konsiderohet një formë korrupsioni. Megjithatë, në Francë kjo është një vepër e veçante penale.



### Ndërhyrja në lehtësimin e dhënies së një miratimi të një vendimi administrativ

Një punonjës është në pritje të një vendimi miratimi nga një organ publik me qëllim që të marrë certifikimin teknik për një sistem izolimi, ku përfshihen disa produkte të Saint-Gobain. Duke pasur parasysh se një prej miqve të tij është i afërt me zyrtarin publik\* që ka autoritetin e lëshimit të këtij vendimi, ky punonjës mendon se duhet t'i kërkojë këtij mikut të tij që të ndërhijë në favor të tij që të përpigjet dhe ta marrë certifikimin më shpejt. Si këmbim, ai mund t'i japë mikut dy bileta për një ndeshje sportive.

**NDALOHET.** Ndalohet që t'i ofrohen avantazhe një pale të tretë me qëllim që kjo palë ta përdorë influencën e saj për të bindur vendimmarrësin për të lëshuar një vendim në favor të Saint-Gobain.

### Cilat janë sanksionet për korrupsionin dhe ndikimin e padrejtë?

Siç theksohet më sipër, korrupsioni dhe ndikimi i padrejtë janë të paligjshme në pothuaj çdo vend dhe mund të çojnë në:

- sanksione të rënda penale (dënim me burg ose me gjobë) si për punonjësit, ashtu edhe për Grupin;
- në kërkesën për të zhdëmtuar palën ose palët e prekura nga korrupsioni ose influencimi i padrejtë;
- shpallje e pavlefshme e kontratave të prokurimit;
- njollosje të rekordeve kriminale;
- skualifikimi nga pjesëmarrja në tendera publikë; dhe
- dëmtim të imazhit dhe reputacionit të Grupit.

Sanksionet (dënimi me burg, gjobat, përjashtimi nga tenderat publikë, etj.) variojnë sipas ligjeve dhe rregulloreve që aplikohen në secilin vend. Si një kompani shumëkombëshe franceze, Saint-Gobain merr masat në veçanti që të veprojë në përputhje me kuadrin legjislativ francez kundër korrupsionit, që është legjislacioni që përdoret ndaj Grupit në raste të akteve të korrupsionit të kryera jashtë Francës.





## Kuadri ligjor dhe rregullator

### Ligjet në fuqi

#### - Ligjet kombëtare

Pothuajse të gjitha vendet në botë kanë miratuar ligje penale që sanksionojnë korrupsionin. Këto ligje zbatohen nga autoritetet lokale të çdo vendi përkatës.

#### - Ligjet me shtrirje jashtëterritoriale

Disa vende, si Franca, kanë miratuar edhe ligje me mbulim përtej territorit të tyre. Këto ligje u japin mundësi autoriteteve relevante nga këto vende që të ndjekin penalisht dhe të vendosin sanksione ndaj akteve të kryera të korrupsionit - nga persona apo nga kompani të ndryshme - përtej kufijve të tyre. Kështu, personat dhe kompanitë mund të ndiqen penalisht për të njëjtën sjellje në disa vende në të njëjtën kohë. Këto ligje me efekte ekstraterritoriale përfshijnë:

#### ***„Akti i Praktikave Korruptive Jashtë Shtetit“ (FCPA) në Shtetet e Bashkuara***

Objekti i zbatimit i FCPA kufizohet tek korrupsioni i zyrtarëve publikë të huaj\*. Ai aplikohet për tre kategori personash:

- çdo kompani që ka siguracione të regjistruara në Shtetet e Bashkuara ose që përndryshe është e detyruar të depozitojë raporte periodike në SEC, si dhe punonjësit, zyrtarët, drejtorët, aksionerët apo çdo person tjetër që vepron në emër të tyre („**siguruesit**“);
- çdo individ që është qytetar, shtetas apo rezident i Shteteve të Bashkuara, si dhe çdo kompani me vend kryesor të ushtrimit të biznesit në Shtetet e Bashkuara ose që është e organizuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara dhe çdo punonjës, drejtor, zyrtar, aksioner apo çdo person tjetër që vepron në emër të saj („**çështjet vendase**“); dhe

- çdo person fizik ose juridik që ka kryer një akt korrupsioni nga toka amerikane ose duke përdorur shërbimet postare amerikane ose çdo mjet tjetër apo mjet tregtar ndërshtetëror (si p.sh. dollarin amerikan, bankat amerikane, etj.) („**juridiksioni territorial**“).

Duke pasur parasysh veprimtarinë e saj të gjerë, Saint-Gobain mund të jetë objekt i FCPA në një numër të madh situatash, duke pasur sidomos parasysh që Grupi është i pranishëm dhe operon në Shtetet e Bashkuara.

### ***Akti i Mbretërisë së Bashkuar kundër Mitmarrjes (UKBA)***

Kjo akt zbatohet për veprat private apo publike të korrupsionit të kryera në Mbretërinë e Bashkuar ose jashtë shtetit nga cilido individ me lidhje të ngushta me Mbretërinë e Bashkuar (me qytetarë apo me rezidentë) dhe nga çdo kompani që e zhvillon gjithë biznesin e saj ose një pjesë të biznesit të saj në Mbretërinë e Bashkuar, pavarësisht se ku ndodhet selia e saj qendrore. Për këtë arsye, kompanitë e Grupit mund të jenë objekt edhe i Aktit të Mbretërisë së Bashkuar për Mitmarrjen.

Mosparandalimi i korrupsionit përkufizohet si vepër penale në Aktin e Mbretërisë së Bashkuar kundër Mitmarrjes, në rastet kur një kompani nuk ka marrë masa mjaftueshëm të forta për parandalimin dhe identifikimin e korrupsionit.

### ***Akti „Sapin II“ i Francës***

Akti Sapin II (që plotëson Kodin Penal Francez parashikon mitmarrjen inkriminuese dhe influencimin e padrejtë) zbatohet për kompanitë e mëdha franceze (që tejkalojnë një prag të caktuar) - si Saint-Gobain - dhe për të gjitha degët dhe kompanitë që ajo kontrollon (qofshin këto franceze apo të huaja). Ky akt kërkon zbatimin e programeve të parandalimit dhe identifikimit të korrupsionit dhe influencimit të padrejtë. Ndaj mosrealizimit të këtyre programeve parashikohen sanksione. Akti Sapin II lehtëson edhe ndjekjen penale të korrupsionit dhe influencimit të padrejtë në Francë, kur këto akte kanë ndodhur jashtë shtetit dhe kur kanë përfshirë zyrtarë publikë të huaj\*.

### **Efektet kumulative të ligjeve të ndryshme**

Si rrjedhojë e juridiksionit ekstraterritorial të ligjeve kundër korrupsionit në juridiksione të caktuara, të njëjtat fakte/akte mund të ndiqen penalisht në disa vende njëherësh.

### Për shembull:

Një drejtor shitjesh britanik të një dege të Saint-Gobain që ndodhet në Kinë dhe që i jep ryshfet një pale të tretë përmes një transferte bankare në dollarë amerikanë mund të ndiqet penalisht:

- në Kinë (aty ku është regjistruar kompania që paguan ryshfetin);
- në Francë (aty ku është regjistruar kompania mëmë e Saint-Gobain);
- Në Mbretërinë e Bashkuar (individi që ka paguar ryshfetin është me kombësi britanike); dhe
- Shtetet e Bashkuara (ryshfeti është dhënë në dollarë amerikanë).

### Konventat ndërkombëtare

Në luftën kundër korrupsionit, ka disa konventa ndërkombëtare, si Konventa e vitit 1997 e OECD-së për Luftën kundër Mitmarrjes së Zyrtarëve të Huaj Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit dhe Konventa e vitit 2004 e Shteteve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

Saint-Gobain është nënshkruese e:

- Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara, ku 10 parimet e saj kërkojnë: „Bizneset duhet të punojnë kundër të gjitha formave të korrupsionit, duke përfshirë edhe zhvatjen dhe mitmarrjen“; dhe



- Udhëzimet e OECD-së për Sipërmarrjet Shumëkombëshe.



## Pagesat për ndërmjetësimin

### Çfarë janë këto?

Pagesat për ndërmjetësimin janë shuma të vogla parash ose çdo lloj avantazhi me vlerë nominale që transferohet ose jepet nga një person në mënyrë jo transparente (d.m.th. pa faturë) një zyrtari publik\* me qëllim sigurimin apo përrshpejtimin e një procedure administrative që çon në një vendim për të cilin personi nuk do të kishte të drejtë ta fitonte ndryshe.

### Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Në shumë vende, duke përfshirë edhe Francën, bërja e një pagese ndërmjetësimi përbën akt korrupsioni dhe është e ndaluar dhe objekt sanksionesh.

### Rregullorja e Grupit

Pagesat e ndërmjetësimit janë rreptësisht të ndaluara brendapërbrenda Grupit, edhe në rastet kur ato autorizohen nga legjislacioni lokal.

### Praktikat më të mira

Çdo punonjës i Saint-Gobain që merr një kërkesë për të bërë një pagesë ndërmjetësimi duhet ta refuzojë atë në mënyrë të sjellshme mbi bazën e kësaj politike dhe duhet ta mbajë shënim\* këtë refuzim.



### Përsheptimi i procedurave doganore

Produktet e Saint-Gobain transportohen nga një vend në tjetrin. Gjatë inspektimeve doganore, zyrtarët e doganave u shpjegojnë punonjësve të Grupit se procedura e autorizimit zgjat 10 ditë. Megjithatë, ata thonë gjithashtu se mund të bëjnë një përjashtim dhe mund ta japin autorizimin menjëherë me kusht që secili të paguaj pesëdhjetë euro para në dorë duke mos marrë asnjë faturë në këmbim.

**NDALOHET.** Paratë e kërkuara nga zyrtarët e doganave\* nuk janë tarifë zyrtare „për shërbim të shpejtë“ që vijnë si pjesë e një çmimi zyrtar të vendosur për të cilin do të lëshonin faturë. Kjo është një kërkesë për pagesë për lehtësimin e shërbimit.

### Dhënia urgjente e vizave

Një punonjëse e Grupit ka nevojë për vizë për të shkuar në Khemed. Ajo kontakton ambasadën, e cila i thotë se procedura standarde për lëshimin e vizave zgjat 15 ditë, por ka edhe një rrugë tjetër me kosto për një procedurë të përsheptuar 48-orëshe.

**LEJOHET.** Nëse punonjësja ka nevojë urgjente për një vizë udhëtimi, ajo mund të paguajë tarifën për një procedurë të përsheptuar kundrejt një kostoje, pasi kjo përkon me shërbimin „premium“, për të cilin lëshohet një faturë transparente dhe e dokumentuar.

## Marrëdhëniet me zyrtarët publikë\*

### Çfarë janë zyrtarët publikë?

Zyrtar publik është një person që ka kompetenca legjislativë, ekzekutive ose gjyqësore në një shtet ose në një qeveri vendore, ose në një subjekt të kontrolluar nga ky shtet apo nga kjo qeveri vendore dhe që kryen një funksion publik ose mision në shërbim të publikut. Duhet theksuar se punonjësit e kompanive apo subjekteve publike, universiteteve dhe organizatave të tjera që kontrollohen tërësisht ose pjesërisht nga shteti apo nga qeveria vendore mund të konsiderohen zyrtarë publikë\* dhe se në disa juridiksione, profesionistët që punojnë në misione me financim publik (p.sh., profesionistët e kujdesit shëndetësor ose ekspertët gjyqësorë) konsiderohen gjithashtu zyrtarë publikë\*.

### Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Korrupsioni i zyrtarëve publikë\* ndiqen penalisht dhe është objekt sanksionesh të rënda. Ai çon në sanksione më ndëshkuese sesa korrupsioni i individëve privatë, pasi shpesh rezulton në përvetësim të fondeve publike.

### Rregullorja e Grupit



Grupi ndalon në mënyrë të rreptë çdo tentativë për të marrë çfarëdo favorizimi nga zyrtarët publikë\* me çdo lloj mjeti, duke përfshirë edhe dhuratat, ftesat, pagesat në cash dhe çdo avantazh tjetër. Po kështu, të kërkuarit e favoreve të tilla nga zyrtarët publikë\* duhet të refuzohen në mënyrë të prerë dhe të qartë. Grupi ndjek politikën e tolerancës zero sa i përket të gjitha formave të korrupsionit, si atyre publike, ashtu edhe atyre private.

### Praktikat më të mira



Punonjësit e Grupit duhet të përdorin logjikën dhe të jenë veçanërisht të kujdesshëm në të gjitha situatat që përfshijnë ndërveprime me një zyrtar publik\*.



### Një zarf dhe unë do mbyll një sy.

Gjatë inspektimit të një fabrike nga një inspektor i sigurisë shëndetësore, inspektori i la menaxherit të nënkuptonte se ishte i gatshëm të mbyllte sytë para një defekti teknik në sistemin e evakuimit në këmbim të një shume të caktuar parash.

**E NDALUAR.** Saint-Gobain duhet të kalojë të gjitha inspektimet dhe të marrë certifikimet dhe autorizimet e nevojshme pa qenë nevoja të japë diçka në këmbim.

### Baneri (Faleminderit)

Një kompani kineze e Grupit arriti të marrë me sukses konfiskimin e produkteve të falsifikuara nga një agjenci qeveritare lokale. Avokati i kompanisë shpjegon se në të tilla situata është e zakonshme që zyrtarëve publikë t'u jepet një dhuratë në formën e një baneri ku shprehet mirënjohja e kompanisë Saint-Gobain.

**LEJOHET.** Një dhuratë e tillë është e pranueshme sepse agjencia qeveritare në fjalë e ka kryer tashmë misionin dhe dhurata është thjesht „simbolike“ dhe nuk ka vlerë monetare rishitjeje.

## Në praktikë

Shih gjithashtu **PAGESAT PËR NDËRMJETËSIMIN** (faqen 2), **TENDERAT PUBLIKË DHE PRIVATË** (faqen 2), **DHURATAT DHE FTESAT** (faqen 2), **MARRËDHËNIE ME AGJENTËT DHE NDËRMJETËSIT** (faqen 2), **dhe BURIMET NJERËZORE - KONTRAKTIMI - PUNËT SI KONTRAKTORË TË PAVARUR OSE PRAKTIKAT PROFESIONALE** (faqen 2).

Referojuni gjithashtu Procedurës së Grupit për pjesëmarrjen në shoqatat tregtare, organizatat e certifikimit ose standardizimit dhe iniciativave të lobimit.



### Çfarë janë këto?

Thirrjet për tender janë procedura të organizuara nga blerësi për gjenerimin e ofertave dhe kuotimeve nga furnitorë të ndryshëm ose ofrues të ndryshëm shërbimi në bazë të specifikimeve të blerësit, ku përcaktohen produktet ose shërbimet që kërkohen të blihen.

Thirrjet për tender janë publike në rastet kur blerësi që e organizon tenderin është subjekt publik dhe private kur blerësi që e organizon tenderin është subjekt privat.

### Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Si çdo proces me për zgjedhje, edhe në procedurat e tenderimit mund të ketë sjellje që çojnë në korrupsion ose influencime të padrejta, si p.sh:

- të paguarit e një shume parash ose të ofruarit e një avantazhi përfaqësuesit të blerësit ose një personi të rrethit të tij të ngushtë familjar ose miqësor;
- influencimi i padrejtë - në këmbim të një pagese -vlerësimi nga ana e blerësit e nevojave të tij për produkte/shërbime ose hartimi i specifikimeve të tij me qëllim favorizimin e një furnitori të caktuar;
- dhënia e informacioneve konfidenciale për tenderin që zhvillohet në këmbim të parave; ose
- përdorimi i nënkontraktorëve që lëshojnë qëllimisht fatura më të larta për qëllime të përfitimit indirekt të përfaqësuesit të blerësit.

### Rregullorja e Grupit



Kur Grupi Saint-Gobain nis një proces tenderimi, punonjësit e Grupit nuk duhet të favorizojnë asnjëherë një ofertues për qëllime personale - d.m.th. për qëllime që nuk lidhen me cilësinë dhe/ose çmimin e produkteve apo shërbimeve të ofruara.

Po kështu, kur Grupi Saint-Gobain i përgjigjet thirrjeve për oferta, punonjësit e Grupit nuk duhet të influencojnë asnjëherë në mënyrë të padrejtë blerësin në asnjë lloj mënyre.

### Praktikat më të mira

Aplikimi i një kujdesi të shtuar në trajtimin e thirrjeve për oferta. Në rast dyshimi, sidomos në lidhje me çfarëdolloj pune specifikuere, kontaktoni departamentin tuaj ligjor ose Departamentin e Etikës dhe Përputhshmërisë.

#### Kontratë për bashkinë

Ndërtesa e bashkisë do të rinovohet dhe për këtë qëllim ka nisur një proces publik tenderimi. Punonjësi i Saint-Gobain i ngarkuar me organizimin e përgjigjeve ndaj thirrjeve për oferta merr vesh se djali i zyrtarit publik që është anëtar i komisionit vendimmarrës ka kontaktuar Saint-Gobain për të blerë materiale për të rinovuar shtëpinë e tij. Punonjësi i Saint-Gobain i ofron zyrtarit publik që t'i bëjë një ulje të pazakontë të birit për materialet e Saint-Gobain që ai ka porositur.

**E NDALUAR.** Qoftë tender publik apo privat, asnjë punonjës nuk mund të ofrojë as edhe avantazhin më të vogël të padrejtë me qëllim influencimin e rezultatit të një procesi tenderimi.

#### Futja e një linje të re produkti

Një kompani e Grupit Saint-Gobain që prodhon produkte tejet novatore për ndërtimin e anijeve të transportit dëgjon për një projekt të ri. Ajo dërgon personin e saj të shitjeve tek firma përkatëse e ngarkuar për këtë projekt për të prezantuar produktet e Grupit dhe për të diskutuar specifikimet e firmës me qëllim që ato të shkruhen në mënyrë të tillë që t'i japin Saint-Gobain mundësinë për të ofruar produktet e tij në përgjigje të thirrjes për oferta.

**E LEJUESHME.** Kjo qasje lejohet kur qëllimi nuk është ngushtimi i gamës së produkteve që mund të ofrohen në kontekstin e tenderit që pritet të zhvillohet (por, përkundrazi, për ta zgjeruar atë) dhe kur kjo nuk përfshin asnjë lloj kompensimi apo avantazhi të padrejtë.

## Në praktikë

Shih gjithashtu **MARRËDHËNIET ME ZYRTARËT PUBLIKË\*** (faqen 2), **DHURATAT DHE FTESAT** (faqen 2), **KONFLIKTI I INTERESAVE** (faqen 2), **VLERËSIMI I RREZIKUT TË KORRUPSIONIT NË MARRËDHËNIET ME PALËT E TRETA NË PËRGJITHËSI** (faqen 2), **MARRËDHËNIE ME AGJENTËT DHE NDËRMJETËSIT** (faqen 2) **dhe PATRONAZHI, DONACIONET DHE SPONSORIZIMET** (faqen 2).

Referojuni gjithashtu Politikës së Grupit për Ligjin e Konkurrencës.



## Dhuratat dhe ftesat

### Çfarë janë këto?

Dhuratat janë diçka që jepet falas: akomodim, dreka/darka, fjetje në hotel, bileta për aktivitete dhe çdo avantazh me vlerë monetare që përfituesi e merr falas.

Dhuratat mund t'u jepen partnerëve të jashtëm si palë të treta, qofshin ata klientë, furnitorë apo ofrues shërbimesh; këto mund të merren edhe nga punonjës të kompanive të Grupit.

### Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Në varësi të rrethanave, dhuratat, argëtimet dhe avantazhet e tjera (drekat/darkat, udhëtimet, akomodimet, etj.) mund të konsiderohen tentativa për influencimin e vendimmarrësit me qëllim marrjen e një avantazhi të padrejtë (një kontratë prokurimi, informacione konfidenciale, terma kontraktuale avantazhues, etj.). Në raste të tilla, sanksionet janë identike me ato që aplikohen për aktet e korrupsionit dhe ndikimit të padrejtë.

### Rregullorja e Grupit

Dhuratat dhe ftesat nuk janë për se të paligjshme kur epen apo merren, pa pritur asgjë si këmbim, por ato duhet të jepen gjithmonë në përputhje të rreptë me Procedurën e Grupit për dhuratat dhe ftesat.

### Praktikat më të mira

Dhuratat duhet të jepen vetëm në shenjë kortezie në kuadrin e marrëdhënieve standarde të biznesit në dritën e praktikave të zakonshme në vendin ku ato jepen. Ato nuk duhet të jepen me qëllim apo duke pasur si synim inkurajimin e marrësit të tyre për të shkelur detyrimet e tij profesionale. Të gjitha dhuratat duhet të jenë për këtë arsye të ligjshme, të arsyetuara me një motiv profesional, të jepen ose të merren në transparencë të plotë dhe në përputhje me kufirin e vlerave të përcaktuara nga çdo subjekt i Grupit. Ju lutem referohuni Procedurës së Grupit për Dhuratat dhe Ftesat për një shqyrtim tërësor të praktikave më të mira të Grupit mbi këtë temë.

### Kutia e shisheve të verës

Një punonjës sapo ka nxjerrë një thirrje për oferta për blerjen e disa ngritësve pirun për tre vitet e ardhshme. Gjatë negociatave komerciale me një nga paraqitësit e ofertave, ky i fundit i jep punonjësit të Saint Gobain një kuti shishesh vere të shtrenjtë.

**NDALOHET.** Këtu është i rëndësishëm momenti i dhënies së dhuratës nga ana e furnitorit me shpresën për të fituar kontratën. Në një situatë të tillë do të hamendësohet se furnizuesi po e ofron dhuratën me qëllim që të përftojë një avantazh të padrejtë (d.m.th. për të fituar kontratën). Në këtë kontekst të gjithë dhuratat duhet të refuzohen, edhe pse kanë vlerë të ulët.

### Një kuti çokollatash

Ndërsa fundi i vitit afrohet, punonjësit e Shpërndarjes të Saint-Gobain duan të falenderojnë furnitorët e tyre duke i dhënë secilit një kuti çokollatash nga një markë shumë e vlerësuar.

**E LEJUESHME** në qoftë se vlera e kutisë së çokollatave nuk tejkalon pragjet e vëna nga njësia në fjalë e Grupit dhe Grupi nuk është i përfshirë aktualisht në negociata me marrësit e dhuratave në atë kohë.

## Në praktikë

Shumë praktika komerciale shpesh përfshijnë oferta promociionale dhe stimuj të tjerë. Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis zbritjeve dhe programeve të rabatit dhe dhuratave dhe ftesave, referuar në këtë Politikë dhe në Procedurën e Grupit për Dhuratat dhe Ftesat. Lidhur me zbritjet dhe programet e rabatit për besnikëri, ju lutemi referohuni Procedurës së Grupit për Praktikë Promociionale dhe nëse është e nevojshme, kontaktoni departamentin tuaj ligjor për këshilla.

# Konflikti i interesave

## Çfarë janë këto?

Konflikti i interesit lind kur interesat personale të një personi në lidhje me jetën e tij private (qofshin të drejtpërdrejta apo të tërthorta) përplasen ose mund të përplasen me interesat e Grupit dhe ndikojnë për këtë arsye në aftësinë e atij personi për t'i kryer detyrat e tij profesionale në mënyrë të paanshme.

Interesat personale në fjalë mund të jenë interesat e punonjësit ose të personave të afërt me të (bashkëshorti/bashkëshortja/partneri/partnerja, rrethi familjar, personat nga të cilët mund të ndikohet punonjësi ose personat tek të cilët ai mund të ndikojë). Konfliktet mund të lindin nga marrëdhëniet profesionale që kthehen në miqësi me kalimin e viteve me një klient, furnitor, partner apo konkurrent të Grupit ose me cilindo agjent tjetër ekonomik apo zyrtar publik\*.

## Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Konflikti i interesit nuk është për se i paligjshëm, por sa herë që krijohet, duhet të zbatohet rreptësisht Procedura e Grupit për menaxhimin e konfliktit të interesit. Në fakt, konflikti i interesit mund të ngrejë dyshime lidhur me objektivizmin, neutralitetin dhe paanshmërinë e një vendimi dhe të krijojë kontekst që lehtëson korrupsionin, ushtrimin e ndikimit të padrejtë, përfitimin e paligjshëm të interesave dhe favoritizmin.

## Rregullorja e Grupit

Për të parandaluar rrezikun e konfliktit të interesit, këto konflikte duhet të identifikohen, të raportohen dhe, nëse është e nevojshme, të rindërmjetësohen, që në momentin që krijohen dhe para se të ndërmerret çfarëdolloj akti tregtar. Qëllimi është që të veprohet në përputhje me Parimet e besnikërisë dhe integritetit të mishëruara në Parimet e Grupit për etikën dhe veprimtarinë.

## Praktikat më të mira

Më e mira është që gjithmonë të parandalohen situatat e konfliktit të interesit. Në fakt, thjesht konflikti në dukje i interesit mund të çojë në



prezumimin se konflikti ekziston vërtet dhe të pengojë kështu bazat e një vendimi, i cili nuk duhet aspak të kundërshtohet.

Në rastet kur një punonjës ndodh të jetë në një situatë konflikti interesi, apo të jetë në një situatë që mund të çojë në një konflikt interesi, ai/ ajo duhet ta raportojë këtë situatë dhe të mbajë shënime\* për këtë raportim, si dhe për çdo masë ndërmjetësuese që merret për adresimin e situatës.

### Mbyllja e njërit sy ndaj një defekti prodhimi

Një furnitor dorëzon një pajisje në fabrikën e Saint-Gobain. Një punonjës i Grupit e inspekton produktin në momentin e dorëzimit dhe konstaton se ai ka një defekt të lehtë. Megjithatë, furnitori qëllon që është vjehërri i punonjësit, gjë që punonjësi nuk ka arritur t'ia përmendë menaxherit të tij. Pas konstatimit se ka një defekt, furnitori shpjegon se ai është defekt i lehtë dhe se nuk ka për të ndodhur përsëri. Ai i kërkon punonjësit që ta pranojë pajisjen e dorëzuar.

**NDALOHET.** Punonjësi duhet ta kishte raportuar këtë konflikt interesi që më përpara sesa të negociohej dhe të firmosej kontrata e furnizimit. Në këto rrethana, punonjësi duhet të çlirohet nga të gjitha detyrimet që lidhen me menaxhimin e marrëdhënies tregtare me këtë furnitor specifik.

### Është një botë e vogël.

Departamenti ligjor për Francën nxjerr një thirrje për oferta për të përzgjedhur një studio ligjore për këshillimin në lidhje me një sërë mosmarrëveshesh që lidhen me produktet. Një prej firmave që iu kërkuar ofertë menaxhohet nga një mik fëmijërie i juristit të brendshëm të Saint-Gobain që punon në këtë Departament Ligjor, por që nuk është i ngarkuar me bërjen e përzgjedhjes përfundimtare.

**LEJOHET.** Megjithatë, juristi i brendshëm në fjalë duhet ta raportojë këtë konflikt interesi n.q.s., në një mënyrë apo në një tjetër, ai përfundon si pjesë e personave që do të menaxhojnë marrëdhënien me këtë studio ligjore. Në këtë mënyrë, në qoftë se ai jep pikëpamjet e tij në lidhje me punën e kësaj studioje ligjore, madje edhe jashtë procesit të përzgjedhjes, opinioni i tij do të interpretohet nga pikëpamja e lidhjes personale me atë firmë.

## Në praktikë

Ju lutemi, referojuni Procedurës së menaxhimit të konfliktit të interesit për një përmbledhje të plotë të mënyrës së trajtimit të këtyre situatave.

## Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit në marrëdhëniet me palët e treta në përgjithësi

### Çfarë do të thotë kjo?

Palët e treta janë të gjithë personat apo subjektet me të cilat angazhohet Grupi Saint-Gobain në mënyrë kontraktuale me qëllim zhvillimin e biznesit të tij: klientët, furnitorët, nënkontraktorët, konsulentët (konsulentët e jashtëm ligjorë dhe këshilltarë të tjerë të ndryshëm), ndërmjetësues, shoqata tregtare, agjenci qeveritare, etj.

### Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Grupi Saint-Gobain mund të jetë përgjegjës për aktet e korrupsionit të kryera nga palët e treta në emër të Grupit ose nëse Saint-Gobain ka qenë në dijeni apo duhet të kishte qenë në dijeni se do të përfitonte nga një akt i tillë.

### Rregullorja e Grupit

Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit që mund të lindë përmes palëve të treta është një shtyllë e domosdoshme e programit të Saint-Gobain për parandalimin dhe identifikimin e korrupsionit. Këto rreziqe duhet të vlerësohen paraprakisht, para nënshkrimit të çdo kontrate me palë të treta dhe sa herë që lindin dyshime gjatë marrëdhënies, duhet të bëhet një vlerësim më i detajuar. Për nga natyra, disa palë të treta dhe disa situata të caktuara mbartin një shkallë më të lartë rreziku, kështu që:

- Agjentët dhe ndërmjetësuesit, si dhe përfituesit e patronazhit, dhuratave apo sponsorizimeve janë objekt i kujdesit të shtuar specifik; dhe
- Ndërveprimet me zyrtarët publikë (që përfshijnë edhe ndërveprimet në lidhje me përfaqësimin e interesave dhe lobimit), si dhe thirrjet për oferta (si publike, ashtu edhe private), mbartin një rrezik më të lartë dhe kërkojnë një mbikëqyrje të shtuar.

## Praktikat më të mira

Punonjësit e Grupit duhet të kontaktojnë me Departamentin e Etikës dhe Përputhshmërisë nëse identifikojnë çfarëdolloj informacioni që mund të prekë nivelin e rrezikut të korrupsionit të palëve të treta.

### Ndryshimi i ofruesve me kërkesë të klientit

Një klient i hershëm i Saint-Gobain bën një kërkesë që nuk pritej: ai dëshiron që Saint-Gobain t'i transportojë produktet në objektin e tij përmes një ofruesi specifik shërbimi që ai dëshiron ta zgjedhë vetë. Përfaqësuesi i shitjeve të Saint-Gobain i ngarkuar me negociatat me këtë klient kundërshton, duke u shprehur se Grupi ka angazhuar tashmë me kontratë transportues të tjerë, por klienti e bën këtë kërkesë si një parakusht për rinovimin e kontratës.

**NDALOHET.** Nëse janë bërë verifikimet e duhura paraprake, kjo kërkesë nuk mund të plotësohet. Kjo mund të jetë një skemë, ku përfaqësuesi i klientit merr një pjesë të të ardhurave të ofruesit të ri të logjistikës, që nënkontraktohet mund të cilësohet si korrupsion.

### Punësimi i një konsulenti për marrjen e një lejeje

Në lidhje me hapjen e një fabrike të Saint-Gobain jashtë shtetit, një punonjës dëshiron të marrë në punë një konsulent lokal për ta ndihmuar Grupin në marrjen e lejeve të nevojshme. Një koleg i jep atij detajet e kontaktit të një kompanie që ndodhet në vendin përkatës. Sipas procedurës së miratimit të palëve të treta, konsulenti klasifikohet si objekt me rrezik të lartë, por ai është miratuar ndërkohë nga një tjetër subjekt i Grupit sipas politikës përkatëse. Prandaj, punonjësi vendos të mos bëjë verifikime për rrezikun e korrupsionit para se të negociojë marrëveshjen e konsulencës.

**LEJOHET.** Nëse është vlerësuar rreziku i korrupsionit të këtij konsulenti, nuk ka nevojë që të ndiqet sërish procedura. Megjithatë, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçante gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, sidomos për t'u siguruar që pagesat e kryera të korrespondojnë me shërbimet e ofruara realisht.

## Në praktikë

Viz také **MARRËDHËNIET ME ZYRTARËT PUBLIKË\*** (faqen 2), **DHURATAT DHE FTESAT** (faqen 2), **MARRËDHËNIE ME AGJENTËT DHE NDËRMJETËSIT** (faqen 2), **PATRONAZHI, DONACIONET DHE SPONSORIZIMET** (faqen 2) dhe (faqen 2).

Referojuni gjithashtu edhe Procedurës së Grupit për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit të palëve të treta dhe procedurës për përzgjedhjen, angazhimin dhe monitorimin e ndërmjetësve. Përveç kësaj, kontratat me furnitorët duhet të parashikojnë edhe një Klauzolë për Blerjen e Përgjegjshme.



## Marrëdhënie me agjentët dhe ndërmjetësit

### Çfarë janë këto?

Ndërmjetësit janë persona apo kompani që lehtësojnë marrëdhëniet e biznesit mes Grupit Saint-Gobain dhe një klienti apo ofruesi shërbimi. Ata mund të jenë agjentë shitjesh, prezantues biznesesh, tregtarë ose konsulentë. Në disa raste, edhe distributorët mund të konsiderohen ndërmjetës, kështu që kjo Politikë vlen edhe për ta.

### Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Studimet e kryera nga organizatat ndërkombëtare tregojnë se në shumicën e rasteve të dhënies së ryshfetit që kanë çuar në dënim, kanë qenë të përfshirë ndërmjetësit. Kjo ndodh sepse përdorimi i këtij lloji të palëve të treta e bën më të lehtë dhënien e ryshfetit (nuk lë gjurmë në llogaritë e kompanisë) dhe për shkak se ndërmjetësit përfitojnë nga dhënia e ryshfeteve\* (ata shpesh paguhen në bazë komisionesh). Megjithatë, pavarësisht statusit të ndërmjetësit (agjent, konsulent, etj.), nëse nga ryshfeti i dhënë përfiton direkt ose indirekt Saint-Gobain, duhet të ndiqen penalisht edhe Grupi dhe punonjësit e përfshirë në këtë proces.

### Rregullorja e Grupit

Marrëdhëniet me ndërmjetësit e shitjeve janë objekt i këtyre rregullave strikte:

1. ndërmjetës, duhet të bëhen verifikime të mëparshme ën përputhje me rregulloren e Grupit;
2. Marrëdhënia duhet të dokumentohet në një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga palët, duke përfshirë edhe dispozita dhe anekse ku përshkruhen në detaje shërbimet për të cilat bihet dakord, kompensimi përkatës, si dhe kërkesat e Grupit kundër korrupsionit; dhe
3. Igjithë procesi duhet të ndiqet me kujdes, sipas procedurave përkatëse, duke përfshirë intervistat dhe përditësimin e informacioneve në rastin e rinovimit të kontratave.

**Praktikat më të mira**

Kur përdoret një ndërmjetës, duhet të verifikoni fillimisht integritetin dhe reputacionin e tyre, si dhe aftësinë e tyre financiare dhe teknike për ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Në një kontratë me shkrim duhet të përcaktohen në mënyrë të hollësishme shërbimet e kërkuara, tarifat që do të paguhen për to, si dhe raportimet e aktivitetit. Përveç kësaj, Saint-Gobain duhet gjithashtu të jetë në gjendje të kontrollojë aktivitetet e ndërmjetësit.

**Tarifat përjashtuese në bazë komisionesh**

Një kompani e Grupit Saint-Gobain ka punuar me një ofrues biznesi në Poldevia për 10 vjet. Marrëveshja midis tyre parashikon një tarifë në bazë të një komisioni 3% deri në 6% në bazë të vlerës së kontratave që vijnë nga ofruesi i biznesit dhe që lidhen nga Saint-Gobain. Drejtori i Shitjeve merr një faturë për pagesën e komisionit prej 8% nga ofruesi i biznesit për një kontratë specifike. Ofruesi i biznesit shpjegon se kjo tarifë përjashtuese është pagesë për përpjekjet dhe kohën e konsiderueshme që atij i duhet të investojë për sigurimin e kontratës për Saint-Gobain.

**NDALOHET.** Drejtori i Shitjeve të Saint-Gobain duhet të mos pranojë të paguajë një komision që tejkalon atë që parashikohet në kontratën me ofruesin e biznesit, me përjashtim të rasteve kur agjenti mund të ofrojë prova konkrete që justifikojnë shumën dhe Drejtori i Shitjeve duhet t'ia referojë këtë çështje menaxherit të tij.

**Distributorët e korruptuar**

Grupi Saint-Gobain planifikon të blejë një biznes të mesëm familjar në Butania. Për pesë vitet e fundit, kjo kompani është bërë aktori kryesor në tregun e izolimit dhe ky aktivitet do të ishte e mira të plotësonte biznesin e grupit në fushën e suvatimeve në atë vend. Procesi i kujdesit të shtuar tregon se kjo kompani punon me një rrjet distributorësh, praktikën e zakonshme të cilëve përfshijnë pagesën e disa tarifave klientëve për sigurimin e kontratave. Kjo praktikë duket nga ana kulturore e pranueshme në Butania dhe të ardhurat e kompanisë do të ishin ndjeshëm më të ulëta nëse kompania nuk vazhdon të procedojë në këtë mënyrë.

**NDALOHET.** Grupi duhet t'i braktisë planet e tij të blerjes në qoftë se nuk zbaton një program të shëndoshë ndërmjetësimi për çrrënjosjen e kësaj praktike të distributorëve dhe të kryejë në mënyrë periodike kontrolle përputhshmërie.

### Ngritja e operacioneve në një vend të ri

Një degë e Grupit Saint-Gobain dëshiron të fillojë aktivitetin në një vend, ku do të fillojnë së shpejti projekte të mëdha infrastrukturore. Duke pasur njohuri të kufizuara për mjedisin lokal, kjo degë vendos të fillojë të punësojë disa agjentë që mund të ofrojnë në gamë të gjerë shërbimesh (studime tregu, shitje dhe shërbime pas shitjes, logjistikë, etj.) dhe të veprojnë në emër të Saint-Gobain si përfaqësuesit e saj lokalë.

**LEJOHET.** Kjo lejohet nëse verifikohet fillimisht integriteti i agjentëve përkatës, nëse lidhet një kontratë që parashikon një kuadër të marrëdhënies së biznesit dhe nëse komisionet që do të paguhen janë në përpjesëtim të drejtë e shërbimet e ofruara dhe në përputhje me praktikën e tregut.

### Në praktikë

Shih gjithashtu **PAGESAT PËR NDËRMJETËSIMIN** (faqen 2), **MARRËDHËNIET ME ZYRTARËT PUBLIKË\*** (faqen 2), **TENDERAT PUBLIKË DHE PRIVATË** (faqen 2), **DHURATAT DHE FTESAT** (faqen 2) dhe **KONFLIKTI I INTERESAVE** (faqen 2).

Referojuni gjithashtu edhe Procedurës së Grupit për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit të palëve të treta dhe procedurës për përzgjedhjen, angazhimin dhe monitorimin e ndërmjetësve.



## Përfaqësimi i interesave dhe lobimi

### Çfarë janë këto?

Përfaqësimi i interesave, i cili njihet më shpesh si lobim, është akti i influencimit në mënyrë direkte ose indirekte të vendimmarrjes publike, si përmbajtjes së një ligji apo rregulloreje, duke ndërvepruar me një ose më shumë vendimmarrës publikë.

Lobimi rregullohet në mënyrë strikte nga ligje të caktuara lokale.

### Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Lobimi është i ligjshëm. Ai kontribuon në funksionimin si duhet të institucioneve qeveritare për aq kohë sa informon ata që janë në pushtet për interesat e ndryshme që luhen, në mënyrë që vendimmarrësit të marrin vendime të shëndosha. Lobimi ndryshon nga influencimi i padrejtë në kuptimin që mjetet e përdorura për të influencuar vendimin përmes lobimit janë të ligjshme: ato bazohen në argumente ekonomike, politike, tregtare ose teknike. Ai bëhet i paligjshëm kur, p.sh., një lobist nuk ka asnjë vlerë të shtuar specifike (si ekspertizë të posaçme në një fushë të caktuar, aftësi bindëse ose akses në një palë të tretë që e ka këtë ekspertizë) dhe kur kontributi i tij i vetëm konsiston me miqësinë me vendimmarrësin publik.

### Rregullorja e Grupit

Në Saint-Gobain, lobimi kryhet kryesisht nga shoqatat tregtare, ku Grupi është anëtar. Në nivelin qendror, nismat lobuese janë të përhapura, në varësi të situatës, nga menaxherët e biznesit, Sekretaritet e Korporatave, Departamentet e Strategjisë, Departamentet e Marketingut dhe Zhvillimit, Departamentet e Zhvillimit të Qëndrueshëm ose nga Departamentet për Përgjegjësinë Sociale të Korporatave (CSR).

## Praktikat më të mira

Individët e përfshirë në aktivitetet e lobimit në emër të Saint-Gobain ose për llogari të tij duhet të veprojnë në përputhje me këto rregulla:

- Të veprojnë në përputhje me rregulloret kombëtare dhe me praktikat më të mira lokale, si dhe të regjistrohen në autoritetet lokale përkatëse nëse është e nevojshme;
- Të veprojnë me profesionalizëm, kujdes dhe integritet, sidomos duke ofruar informacione që janë si të besueshme, ashtu edhe të sakta, si dhe duke shmangur çdo konflikt interesi; dhe
- Të mos bëjnë asnjëherë që një vendimmarrës publik të favorizojë interesat e Saint-Gobain përmes dhënies së një avantazhi të padrejtë të çfarëdolloj.

### Futboll dhe shampanjë

Ndërkohë që në parlament në Guaracha diskutohet një projektligj për rinovimin e energjisë së ndërtesave, Drejtori i Marketingut vendosë që të ftojë disa deputetë nga parlamenti, të cilët Drejtori e di se janë shumë të interesuar për këtë temë, për të marrë pjesë në një lojë futboll në llozhën e VIP-ave me shampanjë dhe ca gjëra të vogla për të ngrënë. Në fund të lojës, Drejtori u jep atyre një dokument me ndryshimet e propozuara në projektligjin në fjalë.

**E NDALUAR.** PNdërkohë që Grupi mund t'i mbrojë në mënyrë legjitime interesat e tij kur projektligji në fjalë mund të ndikojë në aktivitetet e Grupit, kjo duhet të bëhet në mënyrë transparente (d.m.th. pa përzierë biznesin me kënaqësinë e një eventi sportiv) dhe pa asnjë ftesë në ngjarje të caktuara).

### Fushata e komunikimit

Grupi dëshiron të shfrytëzojë një depozitë gipsi nga një objekt në Borduria ku janë prodhuar më parë materiale radioaktive. Pavarësisht publikimit të raportit të një eksperti të pavarur që tregon se operacionet e riparimit të pasojave të ndotjes kishin përfunduar me sukses dhe se ai vend mund të përdorej tashmë pa asnjë rrezik për banorët, popullata lokale vazhdon të jetë armiqësore ndaj këtij projekti. Për të fituar mbështetjen e tyre, Saint-Gobain vendos që të kontaktojë median rajonale, si dhe drejtuesit politikë lokalë për t'u bërë atyre një prezantim më të detajuar të raportit dhe për të shpjeguar pozicionin e kompanisë.

**LEJOHET.** Ofrimi i informacioneve medias dhe vendimmarrësve publikë në mbështetje të interesave të Grupit është një praktikë standarde dhe tërësisht e ligjshme, për aq kohë sa këto informacione janë të sakta dhe ofrohen pa ushtruar asnjë lloj presioni ndaj vendimmarrësve.

### Në praktikë

Shih gjithashtu **MARRËDHËNIET ME ZYRTARËT PUBLIKË\*** (faqen 2), **DHURATAT DHE FTESAT** (faqen 2), **KONFLIKTI I INTERESAVE** (faqen 2), **PATRONAZHI, DONACIONET DHE SPONSORIZIMET** (faqen 2) dhe (faqen 2).

Referojuni gjithashtu Procedurës për anëtarësimin në shoqatat tregtare dhe certifikimin dhe organizatat e standardizimit dhe përfaqësimit të interesave.

## Patronazhi, donacionet dhe sponsorizimet

### Çfarë janë këto?

Një kompani vepron si patron kur ajo ofron mbështetje financiare, ekspertizë apo pajisje një organizate jofitimprurëse pa kërkuar që të marrë asnjë përfitim të drejtpërdrejtë ekonomik si shpërblim. Kjo formë financimi ofrohet me qëllim mbështetjen e aktiviteteve në interes të publikut.

Donacionet janë një mënyrë për të dhënë para, të mira ose shërbime për qëllime bamirësie pa pritur përfitime të drejtpërdrejta si shpërblim nga përfituesi, duke përfshirë edhe çdo përfitim reklamues. Donacionet u jepen përgjithësisht organizatave jofitimprurëse.

Sponsorizimi është një teknikë e marrëdhënieve me publikun. Kompanitë ofrojnë mbështetje financiare dhe/ose teknike në ngjarje sociale, kulturore ose sportive me qëllim përfitimin e drejtpërdrejtë nga kjo mundësi për të promovuar vlerat e tyre kryesore dhe për të rritur reputacionin e tyre.



### Fondacioni Saint-Gobain:

I krijuar në vitin 2008, Fondacioni Saint-Gobain u jep mundësinë punonjësve të Grupit dhe pensionistëve që kanë punuar dikur në këtë Grup për të shprehur solidaritetin e tyre dhe për të kontribuar përmes ndarjes së ekspertizës përmes programeve të bamirësisë të sponsorizuara në përfitim të shtresave të paprivileguara dhe komuniteteve të përjashtuara nga shoqëria në këto fusha:

- integrimi i të rinjve në jetën e punës; dhe
- ndërtimi, përmirësimi dhe rinovimi i strehimeve sociale, duke u fokusuar tek reduktimi i konsumimit të energjisë dhe mbrojtja mjedisore.

Këto programe menaxhohen nga organizata joqeveritare që ndodhen në vendet ku është i pranishëm Saint-Gobain dhe ku sponsorat janë të vendosur në afërsi të projekteve.

## Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Donacionet, patronazhi dhe sponsorizimi mund të përdoren për të fshehur avantazhe të padrejta. Ato mund të përbëjnë ose mund të perceptohen se përbëjnë akte të korrupsionit direkt ose indirekt pavarësisht vlerës së tyre monetare. Ky rrezik është më i madh kur zyrtarët publikë\* kanë një lidhje direkte ose indirekte me ngjarjen ose aktivitetin që përfiton nga donacioni, patronazhi apo sponsorizimi.

### Rregullorja e Grupit

Përfituesit e patronazheve, donacioneve dhe sponsorizimeve duhet që të kalojnë çdo kontroll paraprak të kujdesit të shtuar (sa i përket reputacionit, objektit të aktiviteteve dhe lidhjeve të tyre dhe lidhjeve me personat e ekspozuar politikisht\* (PEP) ose zyrtarët publikë\*).

Përveç kësaj, të gjitha kontributet, qofshin këto në kontekstin e një patronazhi, donacioni apo sponsorizimi, duhet të kalojnë përmes një procesi miratimi që bëhet më rigoroz me rritjen e vlerës së kontributit.

Vëmendje e veçante duhet t'i kushtohet se për çfarë përdoret financimi apo donacioni.

### Praktikat më të mira

Kushtojini vëmendje të veçante nëse përfituesi potencial i patronazhit, donacionit apo sponsorizimit:

- është apo ka lidhje me zyrtarë publikë\* ose me autoritete publike;
- është ose ka lidhje me persona të ekspozuar politikisht (PEP)\*; ose
- ka lidhje me një prej klientëve.

**Patronazhi si parakusht**

Një punonjës i Grupit Saint-Gobain ka negociuar me një kompani të madhe punësh publike për disa javë rresht. Klienti kërkon një donacion për fondacionin e tij ose për fondacionin për të cilin punon bashkëshortja e tij në këmbim të lidhjes së kontratës.

**E NDALUAR.** Një donacion në emrin e Grupit nuk mund të jepet nëse ka për qëllim influencimin e një procesi vendimmarrës në favor të Grupit.

**Sponsorizimi i ndërtimit të një shkolle.**

Një mikeshë e një punonjësi të Grupit Saint-Gobain i jep punonjësit një prezantim të një projekti për ndërtimin e një shkolle, duke kërkuar mbështetje financiare nga Grupi. Ajo nuk i ofron asnjë favor në këmbim dhe as nuk premtim asnjë kusht të favorshëm gjatë negociatave komerciale në të ardhmen (mendohet se kjo shoqe është dhe kliente ose furnitore e Saint-Gobain).

**LEJOHET.** Ky propozim nuk duhet të trajtohet nga Grupi, pasi ai nuk është në përputhje me qëllimin e korporatës së Grupit dhe për këtë arsye nuk mund të miratohet drejtpërdrejt nga punonjësi. Megjithatë, punonjësi mund t'ia paraqesë projektin Fondacionit Saint-Gobain për shqyrtim, por duhet të shpjegojë marrëdhënien që ai ka me personin, projektin e të cilit po prezanton.

**Në praktikë**

Referojuni Procedurës së Grupit për patronazhin, donacionet dhe Sponsorizimet.

## Burimet njerëzore - kontraktimi - punët si kontraktorë të pavarur ose praktikat profesionale

### Çfarë janë këto?

Sa u përket Burimeve Njerëzore, në fazën e procesit të rekrutimit ka disa rreziqe korrupsioni. Dhënia e një praktike profesionale ose një pune si konsulent i pavarur u referohet situatave ku merret në punë një kandidat - me kontratë të përhershme ose të përkohshme - për shkak të marrëdhënies së tij/të saj personale (familjare, miqësore apo marrëdhënie partnerësh) me një klient, furnitor ose zyrtar publik që është i ngarkuar për fillimin apo vazhdimin e marrëdhënies së biznesit apo të çfarëdolloj përfitimi tjetër.

### Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Punët si konsulentë të pavarur mund të jenë një formë e një ryshfeti direkt ose indirekt\*, pavarësisht kohëzgjatjes së kontratës së punësimit. Sanksionet janë më të ashpra kur përfituesit kanë lidhje me zyrtarët publikë\*.

### Rregullorja e Grupit

Për zbutjen e rrezikut të korrupsionit në kuadrin e procesit të rekrutimit, aplikimet shqyrtohen sipas një procedure të bazuar në dy parime kryesore:

- Të gjitha punësimet e reja duhet të bazohen tek kriteret objektive që tregojnë përputhje mes përshkrimit të punës dhe kualifikimeve të aplikantit; dhe
- Të gjitha vendimet për marrje personash në punë duhet të miratohen, sipas rastit, nga menaxheri përkatës ose nga menaxheri i atij menaxheri.

Aplikantët që kanë lidhje personale me një klient, furnitor apo me një zyrtar publik\* nuk duhet të refuzohen në mënyrë sistematike. Megjithatë, këta aplikantë duhet të merren në punë sipas procedurave standarde dhe jo për t'i bërë nder në këmbim të një avantazhi të pritshëm që mund të përfitojë Grupi.



## Praktikat më të mira

Punonjësit nuk duhet t'i ofrojnë kurrë punë brenda Grupit Saint-Gobain një klienti, furnitori apo zyrtari publik\* dhe as familjarëve të personave të tillë apo miqve të tyre me qëllim përfitim të një favorit si këmbim. Nëse rekomandoni një person me të cilin keni një lloj marrëdhënieje për një punë të caktuar, duhet të raportoni këtë konflikt interesi. Përveç kësaj, ju duhet gjithashtu të mos pranoni asnjë kërkesë për punësime si konsulentë të pavarur të personave nga palë të treta dhe t'i regjistroni refuzimet tuaja.

### Praktikë profesionale në këmbim të mbylljes së njërit sy

Gjatë një inspektimi të fabrikës nga një zyrtar i departamentit të punës, punonjësi i ngarkuar me objektin e inspektimit shqetësohet, sepse nuk respektohen disa rregulla të sigurisë. Gjatë intervistës, punonjësi kupton se djali i inspektorit nuk po gjen dot punë. Duke shpresuar se zyrtari publik\* do të jetë tolerant në hartimin e raportit, punonjësi i ofron që ta marrë djalin e inspektorit në kompani për një praktikë profesionale.

**NDALOHET.** Të gjitha inspektimet, certifikimet dhe autorizimet duhet t'i jepen Saint-Gobain pa asnjë quid pro quo.

### Ndihmë për mbesën

Një punonjës rekomandon mbesën e vet për një vend të ri pune në Grupin Saint-Gobain. Ai beson se me arsimimin dhe me përvojën profesionale që ajo ka, do të ishte një kandidate e përsosur për atë përshkrim pune dhe dëshiron që ta dorëzojë vetë aplikimin për punë në Departamentin përkatës të Burimeve Njerëzore.

**LEJOHET.** Duhet të plotësohen këto kushte: të ndiqet procedura standarde e punësimit, punonjësi duhet të njoftojë Burimet Njerëzore për konfliktin e tij të interesit dhe duhet të mos marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.

## Në praktikë

Shih gjithashtu [MARRËDHËNIET ME ZYRTARËT PUBLIKË\\*](#) (faqen 2) dhe [KONFLIKTI I INTERESAVE](#) (faqen 2).

Referojuni [Procedurës së Grupit për menaxhimin e rrezeve të përputhshmërisë në Burimet Njerëzore dhe në procedurat që lidhen me to.](#)

# Shkrirjet dhe blerjet dhe shitjet/ krijimi i shoqërive aksionere

## Çfarë janë këto?

Grupi Saint-Gobain mund të blejë biznese të reja (kompani ose asete të ndryshme), të shesë ose të krijojë shoqëri aksionere me partnerë të jashtëm.

## Çfarë është rreziku i korrupsionit?

Transaksionet e blerjeve paraqesin rreziqe specifike korrupsioni. Aktet e korrupsionit të kryera nga një kompani e synuar para se ajo të blihet mund të çojë në sanksione (si për kompaninë që blihet, ashtu edhe për menaxhimin e saj), duke përfshirë edhe gjopa të rënda që mund të ulin vlerën e kompanisë, të ndërpresin aktivitetin e kompanisë dhe të ndikojnë negativisht në reputacionin e saj. Përveç kësaj, në rast se Saint-Gobain nuk tregon vëmendjen e duhur sa duhet në lidhje me atë kompani për rreziqet e korrupsionit që ajo paraqet para blerjes së saj dhe/ose lejon skemat para-ekzistuese të korrupsionit të vazhdojnë edhe pas mbylljes së saj, Grupi mund të rrezikojë të bëhet objekt sanksionesh.

Përveç kësaj, aktet e korrupsionit të kryera nga një shoqëri aksionere mundet gjithashtu të ndikojnë tek grupi, sidomos (por jo vetëm) kur kjo shoqëri aksionere kontrollohet nga Grupi.

Për më tepër, shitja e një kompanie të Grupit Saint-Gobain tek një palë e tretë e akuzuar për korrupsion ka të ngjarë të ndikojë negativisht në reputacionin e Grupit.

## Rregullorja e Grupit

Për të menaxhuar si duhet rreziqet e korrupsionit, duhet të kryhen disa kontrole para mbylljes së blerjes apo shitjes së një kompanie apo krijimit të një shoqërie aksionere (një „**Transaksion për Rritjen e Jashtëme**“). Përveç kësaj, pas blerjes apo krijimit të një shoqërie aksionere, integrimi i kompanisë së re duhet të organizohet sa më shpejt të jetë e mundur, sidomos sa i përket zbatimit të programit

të Grupit kundër korrupsionit dhe më përgjithësisht, programit të përgjithshëm të përputhshmërisë. Në lidhje me shoqëritë aksionere që nuk kontrollohen nga Grupi, përfaqësuesit e Grupit duhet të kërkojnë zbatimin e kësaj Politike nga organet drejtuese përkatëse në mungesë të një politike ekuivalente. Në rastet kur krijohet një shoqëri aksionere, pavarësisht raportit të pronësisë së Grupit, ngritja e një programi të shëndoshë përputhshmërie duhet të jetë një kusht i panegociueshëm.

### Praktikat më të mira

Departamenti i Etikës dhe Përputhshmërisë përcakton të gjitha kontrollet e kujdesit të duhur që duhet të kryhen në çdo fazë të Transaksioneve të Rritjes me Jashtë:

- Kontrolle paraprake në lidhje me kompaninë e synuar, blerësin potencial në rast të shitjes apo në rastin e krijimit të një shoqërie aksionere me një partner;
- Negociata kontraktuale; dhe
- Integrimi i kompanisë së re (ose kompanisë së synuar).

### Modeli i biznesit i kompanisë së synuar mbështetet tek korrupsioni

Theodoros. Gjatë fazës së kujdesit të duhur\*, janë identifikuar një sërë rreziqesh korrupsioni, sidomos në lidhje me përdorimin e shpeshtë të konsulentëve për të fituar kontrata të mëdha, pa asnjë përshkrim të qartë të misionëve të konsulentëve.

Gjatë procesit të blerjes, drejtuesve të kompanisë së synuar u është shpjeguar qartë se këto praktika do të duhet të marrin fund. Ekipi i integritetit është shprehur në raportin pasues se ky paralajmërim paraprak e ka adresuar mjaftueshëm rrezikun e korrupsionit.

**E PAMJAFTUESHME.** Në rastet kur identifikohen rreziqe korrupsioni gjatë fazës së kujdesit të duhur\* dhe kompania vendos që ta bëjë gjithsesi blerjen, duhet të hartohet një plan i strukturuar ndërmjetësimi me Departamentin e Etikës dhe Përputhshmërisë. Në këtë plan duhet të përfshihen trajnime të detyrueshme për të gjithë stafin, si dhe kontrole sistematike. Sipas rastit, mund të jetë e nevojshme që çdo veprim kriminal të raportohet tek autoritetet përkatëse.

### **Miratimi i programit të përputhshmërisë së partnerit tuaj**

Gjatë negociatave për krijimin e një shoqërie aksionere me një partner, ky i fundit propozon që kompania e re të miratojë programin e saj të përputhshmërisë.

**ELEJUESHME.** Kjo është e mundur nëse programi i përputhshmërisë në fjalë përmbush standardet e Saint-Gobain dhe Grupi ka të drejtë të auditojë shoqërinë aksionere për të parë nëse ky program është zbatuar si duhet.

### **Në praktikë**

Referojuni Politikës së Grupit për përputhshmërinë në kuadrin e Transaksioneve të Rritjes me Jashtë dhe procedurat që lidhen me të.



## Zbatimi i politikës kundër korrupsionit

### Mbikëqyrja e politikës

Drejtimesit kryesorë të Saint-Gobain janë përgjegjës për këtë Politikë kundër Korrupsionit dhe ia delegojnë hartimin dhe zbatimin e saj Departamentit të Etikës dhe Përputhshmërisë.

Në veçanti, ky Departament i Etikës dhe Përputhshmërisë është përgjegjës:

- Për të përcaktuar se si duhet të zbatohet kjo Politikë;
- Për të marrë masat që kjo Politikë të zbatohet plotësisht dhe që të gjitha veprimet të jenë në përputhje me rregullat e parashikuara në të;
- Për të hartuar programe trajnimi dhe fushata informimi për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit dhe ndikimit të padrejtë; dhe
- Përditësimi i kësaj Politike.

Departamenti i Etikës dhe Përputhshmërisë është kontakti kryesor për të gjitha pyetjet (qofshin ato pyetje konceptuale apo praktike) që punonjësit e Grupit mund të kenë për parandalimin apo zgjidhjen e situatave të korrupsionit apo ndikimit të padrejtë. Ai këshillon, mbështet dhe jep rekomandime operationale punonjësve në lidhje me zbatimin e kësaj Politike.

### Përditësimet periodike

Departamenti i Etikës dhe Përputhshmërisë është përgjegjës për përditësimin e kësaj Politike, e cila nuk mund të ndryshohet pa miratimin e tij. Ky Departament shqyrton Politikën aktuale në mënyrë periodike për të reflektuar çdo ndryshim kontekstual apo rregullator, rezultatet e hartës së rrezikut të korrupsionit të Grupit dhe çdo mësim që del nga incidentet që mund të identifikohen.

### **Rolet dhe përgjegjësitë**

Të gjithë punonjësit, pavarësisht pozicionit dhe nivelit të tyre të përgjegjësisë, duhet të veprojnë në përputhje me këtë politikë dhe t'u përmbahen rregullave të parashikuara në të. Kështu, menaxherët vlen të kujtohet se luajnë një rol thelbësor në krijimin, përhapjen dhe ruajtjen e kulturës së përputhshmërisë së Grupit.

### **Raportimi i incidenteve - Sistemi i brendshëm i raportimeve (linja e sinjalizimit)**

Në rast dyshimesh në lidhje me sjelljen që duhet treguar, punonjësit duhet të konsultohen me menaxherët e tyre, me departamentin ligjor ose me [Departamentin e Etikës dhe Përputhshmërisë](#).

Nëse një punonjës beson se një dispozitë ligjore apo rregullatore apo nëse beson se një nga dispozitat e kësaj Politike nuk është respektuar apo pritet që të shkelet, ai/ajo duhet të informojë menjëherë menaxherin e tij/të saj dhe, sipas rastit, të përdorë sistemin e raportimeve të ngritur nga Grupi për marrjen e raporteve nga punonjësit në lidhje me sjellje që bien në kundërshtim me rregullat e parashikuara në këtë Politikë.

Sistemi i raportimit i Grupit mund të aksesohet në:

<https://www.bkms-system.com/saint-gobain>

Referojuni [Politikës për sistemin e raportimit të Grupit Saint-Gobain](#).

### **Sanksione disiplinore për shkelje të Politikës kundër Korrupsionit**

Mosrespektimi i kësaj Politike kundër Korrupsionit mund t'i ekspozojë punonjësit ndaj masave disiplinore që variojnë që nga një paralajmërim i thjeshtë (ose masa ekuivalente me të) deri në pushimin nga puna, në varësi të fakteve. Si kujtesë, Grupi zbaton politikën e tolerancës zero në lidhje me aktet e korrupsionit dhe ndikimit të padrejtë.

Sanksionet e duhura do të jenë ato që parashikon ligji për punonjësën në fjalë dhe do të merren në përputhje me procedurat ligjore përkatëse, veçanërisht në përputhje me të drejtat dhe mbrojtjet në fuqi të punonjësit.

## Shtojcë - përkufizime

### Zyrtar publik

Zyrtar publik është një person që ka kompetenca legislative, ekzekutive ose gjyqësore në një shtet ose në një qeveri vendore, ose në një subjekt të kontrolluar nga ky shtet apo nga kjo qeveri vendore dhe që kryen një funksion publik ose mision në shërbim të publikut. Duhet theksuar se punonjësit e kompanive apo subjekteve publike, universiteteve dhe organizatave të tjera që kontrollohen tërësisht ose pjesërisht nga një organ shtetëror apo nga pushteti lokal mund të konsiderohen zyrtarë publikë\* dhe se në disa juridiksione, profesionistët që punojnë në misione të financuara me para publike (si p.sh., profesionistët e kujdesit shëndetësor apo ekspertët gjyqësorë) konsiderohen gjithashtu zyrtarë publikë.

### Kujdesi i duhur

Termi „kujdes i duhur“ përfshin të gjitha verifikimet që mund të kryejë një blerës apo investitor potencial për të pasur një tablo të saktë të situatës së kompanisë (sidomos sa i përket ekspozimit ndaj rrezikut) para mbylljes së një transaksioni. Më përgjithësisht, „kujdesi i duhur“ i referohet të gjitha verifikimeve që mund të kryhen për palët e treta.

### Regjistrimi

Informimi i personave të përmendur në politikën apo procedurën përkatëse dhe, sipas rastit, përdorimi i mjeteve dixhitale për automatizimin e kësaj detyre.

### Person i Ekspozuar Politikisht (PEP)

„Personi i ekspozuar politikisht“ ose „PEP“ është individ që ka një pozicion apo funksion të rëndësishëm publik ose që është i lidhur me një person të tillë. Për shkak të rolit dhe influencës potenciale, personat PEP konsiderohen si më të ekspozuar ndaj veprave penale të korrupsionit.

### Mitmarrja

Një shumë parash ose një dhuratë e ofruar fshehtazi për marrjen e një avantazhi të padrejtë. Sinonim: pagesë rryshfet.

